

V E N D I M
Nr.452 datë 16.9.1993

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në zbatim të neneve 2, 6, dhe 7 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", quhen persona të mbrojtur:

1. Personat e punësuar sipas një kontrate pune që zgjat për një periudhë të caktuar kohe për më shumë se koha javore e punës.

2. Personat e tjerë ekonomikisht aktivë, të cilët kanë të ardhura nga një veprimtari që zgjat për më shumë se koha javore e punës.

3. Personat e punësuar sipas një kontrate për kohë të ndarë pune, për më pak se 24 orë në javë, sigurohen vetëm për barrë lindje, pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar në nivelin minimal.

4. Personat që punojnë për një periudhë të caktuar kohe për më pak se koha javore e punës, sigurohen vetëm për aksidentet në punë.

5. Punëtorët sezonalë dhe të përkohshëm, të punësuar një kontratë për kohë të caktuar pune, sigurohen për pension pleqërie, invaliditeti, familjar dhe të ardhura për papunësi, kur punojnë jo më pak se 3 muaj çdo vit. Për një periudhë më të shkurtër pune personat sigurohen vetëm për aksidente në punë.

6. Ushtarët e liruar nga ushtria që para kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak kanë qenë të punësuar dhe ndërprerjen e punës e kanë për shkak të këtij shërbimi.

7. Të vetëpunësuarit në bujqësi të aftë për punë që kanë mbushur moshën 16 vjeç dhe që nuk janë të siguruar në sektorë të tjerë, sigurohen në mënyrë të detyrueshme për lejen e barrë lindjes, për pensione pleqërie, invaliditeti dhe humbjen e mbajtësit të familjes.

8. Shtetasit shqiptarë që punonë jashtë shtetit:

a) Sigurohen me kërkesën e tyre, nëse nuk janë siguruar jashtë shtetit, në një nivel së paku aq të favorshëm se ai që parashikon ligji "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë". Sigurimi do të jetë në atë nivel që parashikon kontrata e sigurimit me Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

b) Sigurohen sipas marrëveshjeve të nënshkruara ndërmjet shteteve. Kushtet e sigurimit përcaktohen në kontratat e lidhura për këtë qëllim.

II. Në zbatim të neneve 2, 32, 36, 48 dhe 54, niveli bazë për vitin 1993 është 1237 lekë në muaj.

Në zbatim të nenit 96, kur pensioni do të caktohet nga ligji nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", niveli bazë për vitin 1993 është 528 lekë në muaj.

III. Në zbatim të neneve 9, 10, 14 dhe 90, masa dhe kriteret e kontributeve minimale mujore për vitin 1993 janë:

1. Për degët e sigurimit:

a) të sëmundjeve 24.6 lekë

b) të barrë lindjes 45.9 lekë

c) të pensioneve 519.6 lekë

ç) të aksidenteve në punë e sëmundjeve profesionale 8.2 lekë

d) të papunësisë 98.4 lekë

2. Për personat e punësuar, punëdhënësi derdh kontribut të detyrueshëm në masën 32,5 për qind të listëpagesave mujore në kufijtë e pagës minimale 1639 lekë dhe maksimale 4917 lekë. Duke u mbështetur në këto paga, masa e kontributit minimal mujor është 532.7 lekë dhe maksimal 1598 lekë.

3. Personat e tjerë ekonomikisht aktivë (punëdhënës dhe të vetëpunësuar duke përjashtuar të vetëpunësuarit në bujqësi) derdhen kontribut të detyrueshëm në masën 34.5 për qind të pagës mujore minimale 1639 lekë, që i përgjigjet kontributit mujor minimal 565.5 lekë.

4. Të vetëpunësuarit në bujqësi derdhen kontribut vjetor në masën 15 për qind të të ardhurave fikse vjetore 10.800 lekë, e barabartë me 1620 lekë. Për rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë masa e kontributit vjetor deri në fund të vitit 1995 do të jetë 9 për qind, e barabartë me 972 lekë. Këto kontribute derdhen në agjencitë dhe degët e Bankës së Bujqësisë dhe të Zhvillimit në rrethe e komuna në favor të buxhetit të sigurimeve shoqërore dy herë në vit, si më poshtë:

- Në muajin gusht 30 për qind e kontributit vjetor.
- Në muajin nëntor 70 për qind e kontributit vjetor.

Të ardhurat për lejen e barrëlindjes, pensionet, lindjen e fëmijëve dhe për vdekje paguhen pranë komunave për llogari të fondeve të sigurimeve shoqërore me paraqitjen e dokumenteve përkatës të përcaktuara në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

IV. Në zbatim të neneve 13 dhe 15 të ligjit punëdhënësi detyrohet të paguajë dhe të paraqesë çdo muaj në agjencitë e sigurimeve shoqërore të rrethit listën emërore, pagën mujore dhe masën e kontributit të derdhur për çdo të punësuar.

Të vetëpunësuarit, në kushte të veçanta të pranueshme, mund të paguajnë kontributin me 3 muaj vonesë, ose një herë në 3 muaj, siç do të bihet dakord me agjencitë lokale të sigurimeve shoqërore.

V. Në zbatim të nenit 59 të ardhurat, mbi të cilat llogariten e paguhen kontributet, janë:

1. Pagat që jep punëdhënësi sipas një kontrate pune.
2. Të ardhurat nga një punë e dytë ose nga një punë tjetër, të cilat raportohen te punëdhënësi kryesor, dhe kontributet që rrjedhin prej tyre, nuk duhet të tejkalojnë pagën maksimale të siguruar.
3. Të ardhurat nga vetëpunësimi, pavarësisht nëse personi është i regjistruar.

Nuk quhen të ardhura nga veprimtaria ekonomike dhe nuk u nënshtrohen kontribucioneve kompensimi nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, kompensimi për frymë i shpenzimeve nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë dhe e çmimit të bukës, dhuratat dhe të ardhurat nga detyrimi për ushqim sipas Kodit Civil.

Rregullat për përcaktimin e pagës për efekt të ligjit për "Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" vendosen me udhëzim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

VI. Në zbatim të neneve 53, 54, 55, 57, 84 e 85 për të ardhurat nga papunësia.

1. Për të përfutur të ardhura nga papunësia personat e siguruar duhet të paraqesin kërkesën me shkrim dhe të plotësojnë dokumentacionin përkatës brenda 60 ditëve nga data e lindjes së të drejtës për t'i përfutur këto të ardhura. Në të kundërt ata humbasin të drejtën e përfitimit të të ardhurave nga papunësia, me përjashtim të rasteve kur ata janë të sëmurë të vërtetuar me raport mjekoligjor.

2. Personi që përfiton të ardhura nga papunësia, detyrohet që një herë në muaj, në datën e caktuar ose sa herë që thirret, të paraqitet në zyrën e punës. Nëse nuk paraqitet pa shkaqe të përligjura, humbet të drejtën e të ardhurave nga papunësia.

3. Personi që përfiton të ardhura nga papunësia dhe punësohet ose vetëpunësohet, detyrohet të lajmërojë zyrën e punës brenda 5 ditëve. Në rast të kundërt paguan shumën e të ardhurave nga papunësia që ka përfutur padrejtësisht.

Leja e ushtrimit të veprimtarisë private jepet nga organi kompetent, pasi të jetë marrë vërtetim nga zyra e punës. Me marrjen e kësaj leje e ardhura nga papunësia ndërpritet.

4. Çdo person, gjatë periudhës që merr të ardhura nga papunësia, detyrohet të informojë zyrën e punës për ndryshimet në gjendjen fammijare, nëse personat në ngarkim të tij mbushin moshën 15 vjeç, ose ndryshojnë kushtet e tjera të përfitimit të të ardhurave nga papunësia.

Çdo pagesë e marrë në bazë të informacionit të falsifikuar kthehet.

VII. Personat që përfitojnë nga ligji 7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", përfitojnë kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e disa artikujve ushqimorë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.7.1992, si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.274, datë 12.6.1993 "Për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimit të bukës".

VIII. Marrëdhëniet administrative e financiare ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe bankave do të rregullohen me akte nënligjore të përbashkëta.

IX. Efektet financiare për vitin 1993 janë:

1. Kontributi prej 10 për qind që duhet të derdhin të punësuarit, do të përbalohet nga Buxheti i Shtetit, i cili financon Institutin e Sigurimeve Shoqërore me 135 milionë lekë.

2. Personat e vetëpunësuar në bujqësi duhet të paguajnë në nivelin bazë të kontributit që paguajnë të vetëpronësuarit në qytet. Diferenca e këtij kontributi do të mbulohet nga Buxheti i Shtetit, i cili financon Institutin e Sigurimeve Shoqërore me 640 milionë lekë.

X. Ngarkohet Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të nxjerrin udhëzime në bazë të këtij vendimi.

Të gjitha aktet nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 tetor 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi